

VENDIM
Nr. 41/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 pika 2, në tekstin e betimit, fjalët “do të përpiqem” zëvendësohen me fjalët “do të punoj”.

Neni 2

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas fjalës “moderon” shtohen fjalët “në mënyrë të paanshme”.
2. Në pikën 3, në fund të fjalisë së dytë shtohen fjalët “dhe është në përputhje me rregullat e përfaqësimit në organizatat përkatëse”.
3. Në pikën 4, pas fjalëve “në bashkëpunim me” shtohen fjalët “kryetarët e grupeve parlamentare dhe”.

Neni 3

Në nenin 8 pika 1, fjala “anën” zëvendësohet me fjalën “çështjet”.

Neni 4

Në nenin 10, pika 4 shfuqizohet.

Neni 5

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit

1. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit drejtohet nga dy sekretarët për buxhetin, të cilët përfaqësojnë grupet politike të shumicës dhe të opozitës parlamentare. Ata drejtojnë kolegjisht Sekretariatën për Buxhetin e Kuvendit.
2. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit mblidhet të paktën një herë në tre muaj.
3. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit mblidhet edhe me kërkesë të njërit prej sekretarëve të tij, Byrosë së Kuvendit ose të Sekretarit të Përgjithshëm për të shqyrtuar një çështje të caktuar, që ka lidhje me mënyrën e administrimit të buxhetit të Kuvendit.

4. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, ndjek dhe mbikëqyr të gjitha procedurat e hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Kuvendit që në fazën fillestare të tij e deri në propozimin e tij në Byronë e Kuvendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pas miratimit nga Byroja e Kuvendit, Sekretariati për Buxhetin, gjatë shqyrtimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit, paraqet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat raportin e vlerësimit të projektbuxhetit vjetor të Kuvendit.

6. Sekretariati për Buxhetin, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, kujdesen edhe për administrimin e veprimtarisë së Kuvendit, në përputhje me buxhetin e Kuvendit.

7. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit shqyrton buxhetin faktik të Kuvendit, lidhur me realizimin e tij gjatë vitit të mëparshëm financiar.

8. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit raporton çdo gjashtë muaj në Byronë e Kuvendit për zbatimin e buxhetit të Kuvendit.”.

Neni 6

Në nenin 11, pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.”.

Neni 7

Në nenin 12, pikat 2 dhe 3 riformulohen si më poshtë:

“2. Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare dhe drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Konferenca thirret nga Kryetari i Kuvendit ose me kërkesën e Këshillit të Ministrave apo të një kryetari grupi parlamentar. Në Konferencën e Kryetarëve merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin.

3. Mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve, si rregull, zhvillohen jo më herët se 48 orë nga çasti i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes.”.

Neni 8

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Këshilli kryesohet nga Kryetari i Kuvendit.”.

b) Në fund të pikës 5 shtohen fjalët “brenda 30 ditëve”.

Neni 9

Në nenin 14, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit duhet të jenë me profesion jurist ose të kenë një përvojë të spikatur legjislative.”.

Neni 10

Në nenin 17 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Çdo grupi parlamentar i vihet në dispozicion një sekretar administrativ dhe një këshilltar, ndërsa grupit më të madh parlamentar të shumicës dhe opozitës edhe tre deri në katër këshilltarë për fusha të caktuara të veprimtarisë parlamentare.”.

Neni 11

Në nenin 19 pika 1, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Integrimin European bëhet: “Çështjet e integritetit european, përafrimi i legjisllacionit me *acquis* e Bashkimit European, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit European për Shqipërinë”.

Neni 12

Në nenin 26 pika 2, fjalët “kryetarëve të grupeve parlamentare”, zëvendësohen me fjalët “anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve”.

Neni 13

Në nenin 36, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Gjatë procesit legjisllativ, komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore.”.

Neni 14

Në nenin 38, në fund të pikës 5 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Raporti i Komisionit për Integrimin European është i detyrueshëm për t’u shqyrtuar nga komisioni përgjegjës para miratimit në tërësi të projektligjit.”.

Neni 15

Në nenin 40, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare mbështetet nga programi “Për aktivitetin parlamentar” në buxhetin e Kuvendit”.

Neni 16

Në nenin 42, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Fillimi i çdo sesioni të ri parlamentar bëhet me seancë plenare të Kuvendit.”.

Neni 17

Në nenin 47, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për paraqitjen e projektligjeve, Kryeministri dhe ministri kundërfirmues kanë të drejtë të flasin pa kufizim kohor. Gjatë diskutimeve të tjera ministrat kanë të drejtë të marrin fjalën dhe atyre u jepet sa herë e kërkojnë, por jo më shumë se 10 minuta për çdo ndërhyrje.”.

Neni 18

Në nenin 54 pika 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Seancat plenare të Kuvendit regjistrohen në mënyrë të plotë. Si rregull, për seancat plenare të Kuvendit mbahet edhe procesverbal i përmbledhur.”.

Neni 19

Në nenin 60 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Kur kërkohet me shkrim, nga të paktën $\frac{1}{4}$ e të gjithë deputetëve, votimi i fshehtë bëhet me fletë votimi.”.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:
“3/1. Kur votimi i fshehtë zhvillohet me fletë votimi, ngrihet komisioni i votimit, me përbërje sipas përfaqësimit politik në Kuvend, për aq sa është e mundur.”.
3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
“5. Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenin 109 të Rregullores.”.

Neni 20

Në nenin 63, shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:
“ç) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 10 ditë.”.

Neni 21

- Në nenin 65 pika 2 bëhen këto ndryshime:
1. Në paragrafin e parë, fjalët “nga 7 deri në 21 ditë” zëvendësohen me fjalët “deri në 10 ditë”.
 2. Në fund të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Mbledhja e Byrosë së Kuvendit zhvillohet brenda 48 orëve dhe deputeti, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në të për të paraqitur qëndrimin e tij.”.

Neni 22

- Në nenin 80 bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 1, para fjalëve “komisionet e përhershme” shtohen fjalët “Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit”.
 2. Në pikën 3, pas fjalëve “Në përfundim të shqyrtimit”, shtohen fjalët “Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit dhe”.

Neni 23

- Në nenin 83 bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 1, para fjalëve “nga komisionet e përhershme” shtohen fjalët “Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit dhe”.
 2. Në pikën 2, pas fjalëve “u jepet fjala përfaqësuesve të” shtohen fjalët “Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit dhe të”.

Neni 24

Në nenin 94, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Kërkesa e deputetit i përcillet brenda 2 ditëve institucionit përkatës”.

Neni 25

- Në nenin 105, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
“2/1. Faqja e internetit e Kuvendit, për procedurën ligjvënëse, në mënyrë të përditësuar përmban:
- a) tekstin e projektligjeve të depozituara, së bashku me relacionin shoqërues të tyre;
 - b) kalendarin e punës së komisioneve të përhershme dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve;
 - c) procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave;
 - ç) tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre;
 - d) raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin.”.

Neni 26

Në nenin 106, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dokumentacioni parlamentar mbahet edhe në një regjistër elektronik. Dokumentet parlamentare dhe dokumente të tjera të këtij regjistri, në përputhje me legjislacionin në fuqi, janë drejtpërdrejt të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit të Kuvendit.

Byroja e Kuvendit përcakton modalitetet e zbatimit të kësaj pike.”.

Neni 27

Në nenin 111, pika 7 riformulohet si më poshtë:

“7. Në të gjitha rastet, komisioni përkatës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Komisioni organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat. Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues për plotësimin e tyre.”.

Neni 28

Në nenin 120 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje:

“c/1) shërbimi i monitorimit të institucioneve të pavarura, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, monitoron veprimtarinë e këtyre institucioneve, raportet vjetore, buxhetin e tyre, me qëllim dhënien e informacionit tekniko-ligjor organeve të Kuvendit.”.

Neni 29

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 30.5.2013